



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i Lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 22 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

**Urdhër për Parashtrime të Mëtejshme në Lidhje me Kundërshtimet e Prokurorisë
ndaj Nxjerrjes së Materialeve të Njoftimit të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Haling

Valeria Boliçi

Xhejms Pejs

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), bazuar mbi nenet 21 dhe 40 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji) dhe rregullat 102(3), 106, 108 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 9 shtator 2021, në vijim të urdhrit të Trupit Gjykues,¹ ZPS-ja dorëzoi një shtesë ndaj Njoftimit të saj Përmbledhës sipas Rregullës 102(3) ("Shtesa e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)") që përmbante gjashtëmbëdhjetë materiale ("materialet 185-200").²

2. Më 17 shtator 2021, në vijim të kërkesës së Mbrojtjes për nxjerrjen e këtyre gjashtëmbëdhjetë materialeve të Shtesës së Njoftimit sipas Rregullës 102(3),³ ZPS-ja i kërkoi Trupit Gjykues që të autorizonte, ndër të tjera, mosnxjerrjen e këtij informacioni në bazë të rregullave 102(3), 106 dhe 108 ("Kërkesa").⁴ ZPS-ja i dha Trupit Gjykues materialet 185-190 dhe 192-200.⁵

¹ F00304, Trupi Gjykues, *Urdhër në lidhje me Njoftimin e Hollësishëm të Përditësuar sipas Rregullës 102(3) ("Urdhri")*, 7 shtator 2021; F00304/A01, *Shtojca 1 e Urdhrit në lidhje me Njoftimin e Hollësishëm të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, 7 shtator 2021, konfidenciale dhe *ex parte*.

² F00307, ZPS, *Shtesë e Njoftimit Përmbledhës të Prokurorisë sipas Rregullës 102(3) me Shtojcën Konfidenciale 1 ("Shtesë e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)")*, 9 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ *Shih* F00316, ZPS, *Kundërshtime të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve të Njoftimit të Përditësuar sipas Rregullës 102(3), me një shtojcë konfidenciale dhe gjashtë shtojca konfidenciale dhe ex parte, ("Kërkesa")*, 17 shtator, para. 13.

⁴ Kërkesa, para. 56.

⁵ F00316/A01, ZPS, *Shtojca 1 e Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve të Njoftimit të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, konfidenciale; F00316/A02, ZPS, *Shtojca 2 e Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve të Njoftimit të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00316/A03, ZPS, *Shtojca 3 e Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve të Njoftimit të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00316/A04, ZPS, *Shtojca 4 e Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve të Njoftimit të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00316/A05, ZPS, *Shtojca 5 e Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve të Njoftimit të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00316/A06, ZPS, *Shtojca 6 e Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve të Njoftimit të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

II. DISKUTIM

3. Për marrjen e vendimit lidhur me Kërkesën, Trupi Gjykses duhet të ketë mundësi të arrijë në një përfundim të bazuar mbi informacion lidhur me faktin nëse materialet në fjalë janë objekt i nxjerrjes. Për ta bërë një gjë të tillë, Trupi Gjykses e çmon të nevojshme të sigurojë informacione dhe parashtrime shtesë nga ZPS-ja lidhur me (i) materialin 191 dhe (ii) materialet 195-200.

4. Materiali 191 është një raport të cilin ZPS-ja e ka përfshirë në Shtesën e Njoftimit sipas Rregullës 102(3),⁶ por nuk ia ka dhënë Trupit Gjykses. ZPS-ja i ka dhënë Trupit Gjykses një fragment nga raporti me tre fjali dhe ka parashtruar:

48. Si material i brendshëm pune, ZPS-ja nuk ishte e detyruar t'i njoftonte të akuzuarit lidhur me ekzistencën e raportit. Për arsyet e paraqitura më lart në përputhje me rregullat 106 dhe 108, i kërkohet Trupit Gjykses të mos urdhërojë nxjerrjen e raportit.⁷

5. Me qëllim që të marrë një vendim të bazuar mbi informacion lidhur me faktin nëse dokumenti në fjalë është material i brendshëm pune sipas rregullës 106 të Rregullores dhe nëse, pavarësisht kësaj, i njëjti dokument duhet të nxirret në tërësi ose pjesërisht sipas së njëjtës rregull, Trupi Gjykses duhet të jetë në gjendje ta shqyrtojë dokumentin në tërësinë e tij.

6. Për këtë qëllim, Trupi Gjykses e urdhëron ZPS-në t'i dorëzojë materialin 191 në mënyrë *ex parte* dhe rreptësisht konfidenciale. Në qoftë se e çmon të arsyeshme, ZPS-ja mund të redaktojë në materialin 191 emrin dhe të dhënat e kontaktit (si numrin e telefonit ose adresën) e cilitdo personi para se t'ia dorëzojë këtë material Trupit Gjykses.

7. Për sa u përket materialeve 195-200, Trupi Gjykses vëren parashtrimin e ZPS-së se "të gjitha informacionet e njohura deri më tani konfirmojnë se materialet nuk

⁶ *Shih gjithashtu* Urdhri, para. 24.

⁷ *Kërkesa*, para. 48.

përmbajnë informacion juridikisht thelbësor për pretendimet për shtytje për kryerjen e një vepre penale”.⁸

8. Trupi Gjykses e pranon se duhet të merret si e mirëqenë që parashtrimet e ZPS-së janë bërë me ndershmëri.⁹ Megjithatë, Trupi Gjykses duhet të tregojë kujdesin e duhur lidhur me pretendimet për shtytje për kryerjen e një vepre penale që kanë ngritur të dy ekipet e Mbrojtjes dhe të verifikojë nëse ndonjë nga informacionet që janë objekt i kërkesës aktuale mund të jetë juridikisht thelbësor për pretendimet e Mbrojtjes për shtytje për kryerjen e një vepre penale. Për ta bërë këtë, Trupi Gjykses e çmon të domosdoshme të sigurojë nga ZPS-ja faktet mbi të cilat ZPS-ja bazon pretendimin se materialet 195-200 nuk përmbajnë informacion juridikisht thelbësor për pretendimet për shtytje për kryerjen e një vepre penale. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në që t’ia bëjë të ditur hapat dhe verifikimet e ndërmarra për të përjashtuar mundësinë që këto materiale përmbajnë tregues se punonjës aktualë apo të mëparshëm të ZPS-së ose persona që kanë vepruar nën udhëzimet apo kontrollin e ZPS-së, t’ua kenë dhënë vullnetarisht informacionin e kontestuar të akuzuarve.

III. VENDIM

9. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses **URDHËRON** ZPS-në që deri të martën, 28 shtator 2021, t’i dorëzojë vetëm Trupit Gjykses me anë të një parashtrimi *ex parte* dhe rreptësisht konfidencial:

- a. materialin 191, të redaktuar vetëm në përputhje me paragrafin 6; dhe
- b. faktet mbi të cilat bazon pretendimin se materialet 195-200 nuk përmbajnë informacion juridikisht thelbësor për pretendimet për

⁸ Kërkesa, para. 20.

⁹ IA005/F00008, Paneli i Dhomës së Apelit, *Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelet Kundër Vendimit për Nxjerrje të Informacionit*, 29 korrik 2021, para. 53.

shtytje për kryerjen e një vepre penale, në përputhje me paragrafin

8.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 22 shtator 2021

Hagë, Holandë